



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: Radio Televizioni Dukagjini SH.P.K.

Numri Unik Identifikues: 810420323

Pronar (Aksioner): Dukagjini SH.P.K (person juridik), z. Ermal PANDUARI, znj. Edita DOLI
MUHAXHIRI dhe z. Dardan BELEGU

Kandidati: "RTV Dukagjini"

Adresa: Rr. Gjergj Fishta, Magjistralja Prishtinë – Mitrovicë, km 3, Obiliq



VENDIM

për licencimin e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Adiovizuale "RTV Dukagjini" për transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes – me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2017/02, ka hyrë në fuqi më 25 janar 2017, ndërsa, me Kreun III të kësaj rregulloreje, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes, e që do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore dhe t'i transmetojnë ato përmes cilit do operator të shpërndarjes.
3. Më datën 16 prill 2021, kandidati "RTV Dukagjini", ka parashtruar aplikacionin për licencë të KPM-së për të vepruar si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) për transmetim përmes operatorit të shpërndarjes, me përmbajtje gjeneralistike.

Arsyetim

4. Komisioni konstaton se, Komisioni më datën 23 mars 2021, ka marrë vendim për pezullimin e përkohëshëm të lëshimit të licencave për Ofrues të Shërbimeve Mediale Adiovizuale me transmetim përmes rrjetit të operatorëve të shpërndarjes, respektivisht deri në përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të reja për licencimin e tyre, i cili vendim ka hyrë në fuqi 15 ditë nga data e nënshkrimit të tijë. Përmes të njëjtit vendim është inicuar

edhe procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullorës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (KPM – 2017/02).

5. Komisioni konstaton se Kandidati “RTV Dukagjini” më datën 16 prill 2021, ka dorzuar aplikacionin për licencë të Ofrue Ofrues të Shërbimeve Mediale Adiovizuale me transmetim përmes rrjetit të operatorëve të shpërndarjes, ndërsa dëshmia e pagesës së tarifës administrative për aplikim për licencë, si pjesë e dokumentacionit, mbanë datën e pagesës 10 mars 2021, ndërsa dokumentacionin për aplikim e ka tërhequr më datën 28 janar 2021, pra që konsiderohet se kandidati ka aplikuar brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Komisionit të datës 23 mars 2021.
6. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së OSHMA “RTV Dukagjini”, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhënat e nevojshme për Licencë të KPM-së dhe në pajtueshmëri me Kreun III të Rregullores KPM-2017/02.
7. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së “RTV Dukagjini” ka ofruar të dhënat e mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Materialet e ofruara si pjesë e aplikacionit konsiderohen të qëndrueshme sa i përket skemës programore në përgjithësi; të dhënat rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, përfshirë edhe të dhënat rreth qëndrueshmërisë financiare.
8. Sipas Nenit 21, paragrafit 5 të Rregullores KPM-2017/02, kandidati për licencë të KPM-së “RTV Dukagjini”, duhet të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
9. Komisioni vlerëson se, kandidati “RTV Dukagjini” ka përmbushur kriteret kualifikuese për t’u pajisur me licencë të KPM-së për ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, në pajtim të plotë me Rregulloren e KPM-së KPM-2017/02.

Vendim

10. Komisioni në takimin e tij, të mbajtur më datën 26 maj 2021, merr vendim që kandidatit “RTV Dukagjini”, me seli në Prihstinë, t’i lëshoj licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, për transmetimin e programeve televizive në Republikën e Kosovës.
11. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



26.05.2021
datë